



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr.79/10

Prishtinë, më 14.04.2010, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Gani Koci, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Armend Zemaj, Besa Gaxheri, Xhevdet Neziraj, Suzana Novobërdaliu dhe Mufera Sinik.

Munguan: Naser Osmani dhe Hajdin Abazi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Haki Demolli, Ministër i Drejtësisë, Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave, Ymer Havolli anëtar i TKPK-së, Adrian Zalli drejtor i TKPK-së, Vërshim Hatipi zv.drejtor i TKPK-së, Dino Asanaj Kryetar i Bordit të AKP-së, Avni Jashari drejtor i AKP-së, Osman Ejupi Kryetar i KKK-së, Ahmet Tmava Kryesues i Bordit Qeverisës të KPMM-së, Azem Rexhaj drejtor i KPMM-së, Teki Shala, Ramadan Islami nga GTZ, monitorues nga Zyra e presidentit, OSBE, NDI, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasha Prica Tisma, Vilson Ukaj dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 609 dt. 18.03.2010 dhe Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03-P-204, datë 23.03.2010, për rritjen e numrit të stafit për 17 (shtatëmbëdhjetë) pozita, në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar,
Të ftuar:
Z. Haki Demolli, Ministër i Drejtësisë dhe
Z. Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave;

3. **Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 610 dt. 18.03.2010 dhe Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03-P-205, datë 23.03.2010, për rritjen e numrit të oficerëve korrektues për 71 (shtatëdhjetë e një) pozita në Burgun e Dubravës,**
Të ftuar:
Z. Haki Demolli, Ministër i Drejtësisë dhe
Z. Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave;
4. **Shqyrtimi i Raportit nr. 03/3255/Do-2048 dt. 18.02.2010 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2009,**
Të ftuar: **Përfaqësuesit e Bordit dhe menaxhmentit të TKPK-së;**
5. **Shqyrtimi i Raportit nr. 03/3407/Ra-07 dt. 26.03.2010 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2009,**
I ftuar : **Dino Asanaj, Kryetar i Bordit të AKP-së;**
6. **Shqyrtimi i Raportit financiar nr. 03/3390/Ra-06 dt. 24.03.2010 të Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2009,**
I ftuar : **Osman Ejupi, Kryetar i KKK-së;**
7. **Shqyrtimi i Raportit financiar nr. 03/3456/Ra-09 dt. 31.03.2010 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2009,**
I ftuar : **Ahmet Tmava, Kryesues i Bordit Qeverisës të KPMM-së,**
8. **Shqyrtimi i Raportit nr. 03/3247/Do-204 dt. 16.02.2010 të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2009,**
I ftuar : **Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit të Republikës së Kosovës;**
9. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Besa Gaxherri theksoi se rendi i ditës është shumë i ngarkuar, kemi pesë raporte shumë të rëndësishme që nuk do të mund të trajtoheshin brenda kësaj mbledhje, ashtu siq kërkojnë ato. Propozoi që të paktën dy pika të shtyhen për në mbledhjen e radhës, ndër ato edhe Raporti i Kuvendit për 2009.

Kryesuesi njoftoi se rendi i ditës është hartuar në bazë të materialeve që janë dërguar Komisionit për shqyrtim. Megjithatë nëse edhe anëtarët tjerë mendojnë që heqin nga rendi i ditës pikën e tetë, edhe do të pajtohej.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime. Pika e tetë e rendit të ditës shtyhen në mbledhjen e radhës së komisionit, ndërsa pika e nëntë bëhet pika tetë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për rritjen e numrit të stafit për 17 (shtatëmbëdhjetë) pozita, në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar

Kryesuesi vlerësoi kërkesë të arsyeshme, kur dihet fakti se edhe e kemi miratuar Ligjin me të cilën parashihet krijimi i agjencionit. Të gjinden modalitetet për aprovimin e saj, duke mos kaluar kufijtë buxhetor.

Haki Demolli - Ministër i Drejtësisë, pas miratimit të ligjit për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar është paraparë krijimi agjencionit dhe si rezultat kërkohej mjete për

pranimin e stafit të ri prej 17 pozita dhe mjeteve buxhetore për këto shtatë muajt e mbetur në vlerë prej 418.354€. Në vazhdim arsyetoi këto mjete sipa kategorive ekonomike.

Ahmet Shala - Ministër i MEF-it thekoi se pajtohet me kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, dhe nëse Kuvendi e aprovon mund të ndryshohet numri i punëtorëve, dhe shpenzimet deri në rishikim të buxhetit duhet mbuluar nga buxheti i brendshëm i ministrisë dhe rezervat buxhetore, ndërsa në rishikim buxhetor do të rregullohet kjo çështje, duke mos kaluar kufijtë e jashtëm buxhetor.

Kryesuesi theksoi se komisioni mund t'i rekomandoj Kuvendit rritjen e numrit të punëtorëve dhe mbulimin e shpenzimeve deri në rishikim të buxhetit nga Ministria e Drejtësisë, ndërsa në procesin e rishikimit të buxhetit të parashihen mjete për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandohet Kuvendit të miratojë propozim – vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për rritjen e numrit të punëtorëve për 17 (shtatëmbëdhjetë) pozita në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar, në organizatën buxhetore – Ministria e Drejtësisë.
- II. Shpenzimet buxhetore deri në rishikim të buxhetit të mbulohen nga burimet e brendshme buxhetore të Ministrisë së Drejtësisë, dhe në procesin e rishikimit të buxhetit 2010, Qeveria të sigurojë mjetet të rregullta financiare për mbulimin e këtyre shpenzimeve, duke mos kaluar kufijtë e përgjithshëm të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010.

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për rritjen e numrit të oficerëve korrektues për 71 (shtatëdhjetë e një) pozita në Burgun e Dubravës

Haki Demolli njoftoi se institucioni korrektues në Burgu i Dubravës është në ndërtim e sipër, është përgatitur plani dhe janë paraparë 71 pozita të reja, shuma totale e buxhetit për shtatë muaj që kërkohet është 589.603€. stafi mbështetës do të përcillet nga pjesa tjetër e shërbimit korrektues, e që në këtë drejtim nuk do të ketë rëndim të buxhetit të Kosovës.

Ahmet Shala - Ministër i MEF-it njoftoi se kemi sugjeruar që kjo çështje të rregullohet nga burimet e brendshme të ministrisë dhe rezervat buxhetore gjatë kësaj faze, ndërsa gjatë rishikimit të buxhetit, kemi rekomanduar që të zgjidhet kjo çështje.

Armend Zemaj theksoi se është edhe obligimi institucional që të krijojmë kushte për funksionalizimin e institucionit korrektues, madje edhe nga raporti i progresit është thënë se mungon Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve apo në këtë rast Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve të dënuar. Është një kërkesë e arsyeshme dhe urgjente dhe qysh tani duhet planifikuar mjete të rregullta buxhetore për funksionalizimin e këtij institucioni.

Besa Gaxherri vlerësoi arsyeshmërin e kërkesës dhe theksoi se është obligim institucional të sigurohen mjete financiare për implementimin e ligjeve. Kërkesat e ndryshme apo projektligjet duhet t'iu nënshtrohen vlerësimit financiar të implementimit të tyre dhe duhet të ndryshojë praktika që gjërat të kalohen ad hoc.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandohet Kuvendit të miratojë propozim – vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për rritjen e numrit të oficerëve korrektues për 71 (shtatëdhjetë e një) pozita, në Burgun e Dubravës, në organizatën buxhetore – Ministria e Drejtësisë.
- II. Shpenzimet buxhetore deri në rishikim të buxhetit të mbulohen nga burimet e brendshme buxhetore të Ministrisë së Drejtësisë, dhe në procesin e rishikimit të buxhetit 2010, Qeveria të sigurojë mjetet të rregullta financiare për mbulimin e këtyre shpenzimeve, duke mos kaluar kufijtë e përgjithshëm të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010.

4. Shqyrtimi i Raportit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2009

Armend Zemaj pasi që ka qenë kërkesë e komisionit dhe në këtë raport nuk është përfillë çështja e publikimit të pagave të menaxhmentit të trustit dhe deri sa kjo nuk ndodh, nuk do të marrë pjesë në debat për këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi duke u ndërlidhur me parafolesin, theksoi se e kupton kërkesën e tij, por përderisa trusti ka thënë se do të sjellin një raport më të detalizuar, të presim që kjo çështje do të përfshihet në atë kohë.

Ymer Havolli përkundër krizës financiare në tregjet botërore, strategjia e bordit që mos të shiten aksionet e trustit, ka ndikuar rritjen e vlerës së tyre dhe kthimin e një pjese të mjeteve, viti 2009 ndër vitet më të suksesshme gjatë të cilit është kthyer një sasi e mirë e rënies së vlerës së aseteve si rezultat i rritjes së tregjeve. Modeli i pagesës dhe të ardhurave të menaxhmentit është i ngjashëm me modelin e paraparë nga BQK-së.

Adrian Zalli njoftoi se si rezultat i moshtijes së aksioneve vitin e kaluar, kthimi i vlerës së mjeteve të investuar kanë shënuar progres mbi 14% apo 46 milion €. Një shtim të madh të kontribuesve, mbi 30.000 më tepër se vitin e kaluar. Vitin 2009 e kemi përmbyllur me 380 milion € mjete nën menaxhim.

Vërshim Hatipi njoftoi se raporti është hartuar konform rregullave të përcaktuara për BQK-ja për raportim. Bordi në mbledhje e parë ka vendosur të heq dy investues të menaxhimit të mjeteve që janë konsideruar më të rrezikshëm. Pjesa më e madhe e shpenzimeve shkojnë për menxhuesit e mjeteve, ndërsa pjesa tjetër për nevojat e brendshme të trustit. 16 mili € e mjeteve janë të investuar në Kosovë, ndërsa pjesa tjetër jashtë vendit, duke mos i përmendur mjetet në BQK, ndërsa nuk ka pasur investime gjatë vitit 2009. Në pyetjen për numrin e punonjësve të trustit, njoftoi se informatat janë të pasqyruara në raport.

Myrvete Pantina pasi që ka qenë kërkesë e Komisionit, theksoi se do të ishte mirë të bashkëngjitej edhe një listë e pagave të punëtorëve të TKPK-së, që të shohim diferencat e nivelit të pagave të anëtarëve të bordit, menaxhmentit dhe punëtorëve tjerë të trustit dhe shfaqti shpresën se kjo do të prezantohet në raportet e ardhshme. Nga raporti shifet se buxheti është realizuar 75%, pra kemi suficit, pyeti a do të thotë kjo se mund të pritët që taksa menaxhuese të zbritet edhe më tutje?

Armend Zemaj vlerësoi përmisimin e situatës së rritje e vlerës së mjeteve të investuara në tregun financiar brenda dhe jashtë vendit. Megjithatë nuk kemi kthim të mjeteve por rritje të tyre. Sa i përket

çështje së pagave nuk është kërkesë e imja personale, por është çështje e mandatit dhe transparencës, për të bërë publike nivelin e pagave të punëtorëve të menaxhmentit të trustit.

Kryesuesi mbështeti propozimet që në raportet e ardhshme të bëhen publike pagat e punëtorëve të trustit. Por megjithatë e rëndësishme është të diskutohet çështja ndryshimit dhe plotësimit të ligjit dhe të rregullohen me ligj çështja e nevojës së investimeve brenda dhe jashtë vendit. Kemi pasur rënie të vlerës dhe jo humbje të mjeteve, dhe tani kemi rritje të vlerës së tyre.

Xhevdet Neziraj vlerësoi kthimin e një pjese të mjeteve të investuara. Edhe pse kemi zvogëluar taksën, si rezultat i rritjes së kontribuesve prapë jeni në atë shumë. Pasi që kemi të investuar rreth 16 milion € në Kosovë, pyeti sa ka mundësi të investohen prapë mjete në Kosovë, që janë të dobishme për ekonominë e Kosovës?

Safete Hadërgjonaj pyeti për numrin e punëtorëve të trustit, duke përfshirë anëtarët e bordit dhe punonjësve të tjerë të trustit?

Besa Gaxherri pasi që ligji thotë se vetëm 5% e mjeteve mund të investohen në Kosovë, pyeti na bazë të menaxhimit të juaj dhe situatës aktuale, a mendoni se janë krijuar kushtet që të ndryshohet kjo shifër dhe investimi të jetë më i madhë. Sa i përket mjeteve të investuara në bankat që operojnë në Kosovë, pyeti sa është norma e interesit dhe a jeni të kënaqur duke krahasuar me mjetet e investuar në tregjet financiare jashtë vendit?

Adrian Zalli në përgjigjen e parafolësve në çështjen e investimeve të mjeteve, theksoi se kjo është subjekt i ligjit. Sa i përket investimi të mjeteve në bankat vendore, ka pasur raste kur bankat që operojnë në Kosovë nuk kanë pasur interes për mjetet e trustit se kanë lidiukitet të tepërt. Sa i përket kamatave nga bankat vendore para dy viteve kanë qenë 5.5 %, por më vonë janë ulur ofertat, tani janë 2.2%. Edhe në vendet tjera nuk praktikohet që shumica e mjeteve të investohen në një institucion, prandaj edhe është vendosur shuma prej 5 % me ligj. Sa i përket taksës menaxhuese, kërkesa e zvogëlimit të saj, do të varet nga nevoja për mjete, për mbulimin e shpenzimeve për menxhuesit e mjeteve dhe për nevoja të trustit.

Kryesuesi theksoi se ndihet nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, sidomos në pjesën e investimit të mjeteve, dhe ju si profesionistë në këtë drejtim, nga analizat e juaja në investimin e mjeteve në tregjet financiare, mund të sjellin propozimet dhe sugjerimet konkrete me shkrim për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.

Ymer Havolli si bord jemi të interesuar në ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, që do të krijonte bazën ligjore për investimin e mjeteve në tregun vendor. Do të shikojmë praktikën më të mira të vendeve të rajonit në pjesën që ka të bëjë investimin e mjeteve. Sa i përket të ardhurave të punëtorëve të TKPK-së, të gjitha të dhënat janë të njohura për BQK-në, po ashtu edhe pasuria e anëtarëve të bordit është deklaruar në Agjencinë Kundër Korrupsionit, dhe ato do të jenë pjesë agregate e raportit, që do t'iu dërgojmë.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandohet Kuvendit që seancën plenare, të miratojë Raportet e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2009.

- II. Në raportin e tremujorit të parë për vitin 2010 të Trustit drejtuar Kuvendit, rekomandohet që të pasqyrohet edhe niveli i pagave të anëtarëve të bordit dhe punëtorëve tjerë të TKPK-së.

5. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2009

Kryesuesi vlerësoi raportin të gjithëpërfshirës dhe i cili përmbush rregullat ligjore për raportim.

Avni Jashari njoftoi se raporti është hartuar konform udhëzimeve të MEF-it dhe standarteve ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik. Gjatë vitit 2009 AKP-ja ka shpenzuar 12.715.000 €. Ndërsa fondi i AKP-së nën menaxhim është 403.545.000 € dhe të gjitha këto mjete janë të depozituara në llogaritë rrjedhëse të BQK-së.

Myrvete Pantina vlerësoi raporti gjithëpërfshirës dhe të hartuar mirë. Në vazhdim bëri disa pyetje: Çfarë do të ndërmerrni ndaj ndërmarrjeve të privatizuara me spin of special, që nuk i kanë përmbush përmbushur kontratat? Sa është norma e interesit për mjetet e investuara në BQK bankat tjera, si Procredit dhe Reiffisien bank dhe a dihet ku janë investuar ato? Pasi që ndarja e 20% është ende e ultë, pyeti çfarë do të ndërmerrni në këtë drejtim?

Kosara Nikolić vlerësoi raporti financiar të AKP-së të hartuar mirë së në aspektin tekstual po ashtu edhe në atë tabelor. Në vazhdim u interesua të dinte se përputhen të dhënat e prezantuar në raport me situatën në teren, sa i përket çështjes numrave të listës preliminare të ndarjes 20%. Këto lista janë paraqitur pas afatit, për çka palët e interesuara e kanë humbur mundësinë e ushtrimit të drejtës së ankesës. Rasti i një ndërmarrje, ku në listën preliminare janë paraqitur 11 punëtor, ndërsa në raport kemi të prezantuara 33 dhe mendoj se më vonë do të ketë raste të tilla më të shumta në gjykatë.

Xhevdet Neziraj duke pasur parasysh faktin se me disa ndërmarrje ndarja e 20% është bërë pjesë-pjesë, pyeti pse po ndodh kështu dhe nuk po bëhet shpërndarja përnjëherë?

Armend Zemaj vlerësoi raportin të mirë që përmbush kushtet e raportimit. Më pas pyeti a keni bërë ndonjë studim në çështjen e premtimeve dhe zotimeve të investitorëve, që përveç obligimit të përmbushjes së kontratave, t'iu ndihmohet që t'i realizojnë premtimet, që është në interes të zhvillimit ekonomik. Cili është kontributi juaj si AKP në këtë drejtim, që të mos dështoj procesi i privatizimit?

Besa Gaxherri vlerësoi raportin gjithëpërfshirës dhe profesional. Megjithatë procesin e privatizimit po e përcjellin shumë probleme dhe mëdyshje. Më pas bëri disa pyetje: Qfarë po ndodh me ndërmarrjet e privatizuara me spin of special, që nuk kanë respektuar kontratat? Qfarë nënkupton ofruesit në shërbime në të holla bruto dhe neto? A janë reale tabelat e pasqyruara në raport sa i përket ndarjes së 20%? Si janë raportet e AKP-së me BQK-në.

Kryesuesi theksoi se nuk duhet të ketë shtyerje të afateve për ndërmarrjet e privatizuara spin of special në çështjen e përmbushjes së obligimeve të tyre? Në fq. 53 thuhet numri i punëtorëve të zotuar, raportuar dhe konfirmuar, pse kaq i madhë, një sqarim?

Dino Hasanaj sa i përket ndërmarrjeve me spin of special, problemet janë të trashëguara nga AKM-ja. AKP-ja nuk privatizon ndërmarrjet në këtë formë dhe mendimi im është se ka qenë një sistem i gabuar dhe i dështuar. Nga privatizimi i këtyre ndërmarrjeve kemi kontrata të ndryshme, ku parashihet paga 80€, premtimi për punësimin e shumë punëtorëve, por jo kualitativ. Nuk janë studiuar mirë biznes planet e blerësve për të parë sa kanë qenë reale zotimet për punëtor. Ndërsa tani ne bëjmë monitorimin, auditimin dhe vlerësimin real të investimeve. Për këto probleme, fajtor janë të dy palët

(AKM dhe investitori). Sa i përket marrëdhënieve me BQK-në, nuk kemi informacione se për mjetet tona, interesi është 0.1%. Sa i përket listave të 20%, është obligim i sindikatave ti dorëzojnë emrat e ishpunëtorëve. Ne kemi bërë shpalljet edhe në gazeta në serbi, mal të zi, dhe në mungesë të informimit dhe komunikimit, ka mundur të mos shfrytëzohet e drejta për ankim.

Besa Gaxheri përgëzoi parafolësin që si person zyrtar deklarohen hapur për problemet e privatizimit, sidomos privatizimit të ndërmarrjeve me spin of special. Duhet rishikuar këtë proces dhe personat përgjegjës që sot janë në krye të qeverisë, duhet të japin llogari. Në dështimin e këtij procesi fajtor kanë qenë institucionet vendore dhe ndërkombëtare jo investitorët, duke vendosur kritere që edhe e kanë sjellur këtë situatë. Uroj që AKP-ja të mos ketë presione në punën e saj dhe sugjeroi që të sjellin propozime konkrete për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, që procesi i privatizimit të ecën më mirë.

Avni Jashari në pyetjen e parafolësës, theksoi se ofruesit në shërbime në të holla bruto janë pagesat pa tatime dhe pensione, ndërsa neto kur AKP-ja paguan me tatimet dhe pensionet.

Kryesuesi theksoi se shifet nevoja për ndryshimin e ligjit dhe se nga përvoja dhe ekspertiza, AKP-ja të bëjë analiza dhe të sjellin propozime konkrete për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. I rekomandon Kuvendit që në seancën plenare, të miratojë Raportin financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për 2009.
- II. Me qëllim të menaxhimit dhe implementimit më të mirë të procesit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Komisioni i propozon Kuvendit që në koordinim me Qeverinë dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të iniciojë procedurën e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr.03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

6. Shqyrtimi i Raportit financiar i Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2009

Kryesuesi njoftoi për shkresën e MEF-it për mosdorëzimin e pasqyrave financiare të këtij komisioni për vitin paraprak. Sa i përket raportit nuk plotëson standartet për raportim, i njëjti të plotësohet konform formularëve dhe rregullave për raportim, para shqyrtimit të tij në Kuvend.

Osman Ejupi mosdorëzimi pasqyrave financiare në MEF për shkak të mosdijes dhe mungesës së zyrtarit financiar. Raportin financiar e kemi hartuar pa marrë ndonjë model. Më pas foli për problemet me munguesen e zyreve dhe kushteve për punë. Si dhe njoftoi se është draftuar ligji i ri konform standarteve evropiane dhe i njëjti është në procedurat e qeverisë.

Safete Hadërgjonaj u pajtua me konstatimet e kryetarit se në mungesë të kushteve për punë, mund të ketë edhe reflektime në kryerjen e detyrave, në këtë rast hartimit të raportit. Megjithatë do të ishte mirë që raporti financiar të plotësohej para shqyrtimit të tij në Kuvend dhe të jetë i gatshëm me rastin e shqyrtimit të raportit të qeverisë për buxhetin 2009.

Besa Gaxherri duhet t'i rekomandojmë institucionet përkatëse, që këtij komisioni t'i krijohen kushteve elementare për punë dhe kompletimi e stafit.

Xhevdet Neziraj nga raporti shifet se është shpenzuar buxheti për pagat, pse nuk është punësuar një punëtor për financa?

Kryesuesi komisioni do të rekomandojë krijimin e hapësirave dhe përmisimin e kushteve të mjaftueshme për punë, për funksionalizimin dhe operacionalizimin më të mirë të këtij komisioni.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. I rekomandon Kuvendit që në seancën plenare, të miratojë Raportin financiar të Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2009.

7. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2009

Ahmet Tmava njoftoi se raporti është i detalizuar dhe më pas shpjegoi përmbajtjen e raportit.

Safete Hadërgjonaj nga raporti shifet se me paga keni ecur mirë nga viti në vit. Kërkoi një sqarim për shumat e larta për udhëtimet jashtë vendit dhe avanset për vizita studimore dhe zyrtare. Sa i përket shpenzimeve për servisimin dhe karburante po ashtu janë të larta, por kjo ndoshta për shkak të punës në teren. Mineralet energjetike janë faturuar më pak dhe janë paguar më shumë, një sqarim?

Suzana Novobërdaliu kërkoi disa sqarime për “shpenzimet tjera telefonike vala 900”, “shërbimet tjera kontraktuale” dhe shpenzimet “paisje tjera”. Pyeti a jeni ende në ndërtesë me qira?

Myrvete Pantina pyeti pse nuk janë shpenzuar krejtësisht subvencionet, kur keni pasur mundësi? Ndërsa në dy vende është përmendur mirëmbajtje e teknologjisë informative, ndoshta gabim teknik?

Azem Rexhaj në përgjigjen e pyetjes për shumë e lartë të karburanteve për shkak të punës në teren, shpenzimet për tel, për shkak të natyrës së punës dhe nevoja për komunikim në teren për stafin. Paisjet tjera janë paisjet e teknologjisë informative, softuerike, UPS, afata digjital dhe paisje tjera elektronike. Shpenzimet kontraktuese si rezultat i ndërrimit të objektit të ri. Shënimi dy herë mirëmbajtje e teknologjisë informative, gabim teknik dhe duhet të jetë “servisimin dhe kalibrimi i paisjeve gjeodezike”. Avanset për udhëtimet jashtë vendit për shkak të pjesëmarrjes në trajnime. Sa i përket problemit të qirasë, që nga viti 2006 është kërkesë e jona që të zgjidhet ky problem.

Besa Gaxherri për shkak të natyrës së punës dhe duke pasur parasysh faktin se Prishtina kryesisht nuk miniera dhe minerale, pyeti a mendoni që mund të vendosni në ndonjë objekt jashtë Prishtine? Psh. në Mitrovicë.

Ahmet Tmava pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme përveç trajnimit, ka pasur për qëllim edhe prezantimin e resurseve minerale për joshje të donacioneve. Është e mundur që të ndërrojmë lokacionin, zyret tona janë edhe në rajon

Kryesuesi kërkoi që të sillet një listë plotësues e borqlinjëve të mëdhenj dhe të vegjël që kanë ndaj KPMM-së.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. I rekomandon Kuvendit që në seancën plenare, të miratojë Raportin financiar të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2009.

8. Të ndryshme.

- 8.1.** Njoftoi anëtarët me kërkesën e sekretarit të Kuvendit, për mundësinë e propozimit të emrave të ekspertëve me CV e tyre që të mund të futen në bazën e të dhënave të ekspertëve, që do të mund të angazhoheshin nga komisioni në nevojat e tij dhe nga mjetet e parapara për këtë qëllim

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Gani Koci
